

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.H. nga fsh. ... KK..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.799/2017 të datës 23.05.2017, të cilën e përfaqësonte prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 23.01.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.H.**, nga i ati R. dhe nëna H., e lindur T., i lindur më date: ...në fsh..., tani jeton në fsh. ..., KK... i martuar baba i katër fëmijëve, mësimdhënës i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse

Me datën 04.05.2017, rreth orës 12.00 h , në ..., i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës “ ... ”, me tabela regjistrimit ..., në një rrugicë afër autopjesë “ ... ” në drejtim të udhëkryqit ne rr. “ ... ” nga pakujdesia, ka shkelur Ligjin për Rregullimin e Trafikut Rrugor nga neni 61 paragrafi 1. Përkatësisht vozitësi me të arritur në rrrugën me përparësi kalimi në udhëkryq edhe pse ka qenë i obliguar që t'i jap përparësi të gjitha mjeteve që qarkullojnë në atë rrugë i njëjti ka bërë kthimin majtas në drejtim të ... nga rruga dytësore pa u bindur më parë se me këtë veprim mund të pengoj ose rrezikojë pjesëmarrësit tjerë në trafik dhe për pasojë me derën e parë të majtë godet në pjesën e përparme të majtë automjetin e markës “ ... ” me tabela regjistrimi ... të cilin e drejtonte M.A. i cili po lëvizte në rrugën magjistrale kryesore ... – ... në drejtim të qendrës së ... dhe nga kjo goditje përpos dëmeve materiale lëndime trupore pëson edhe i dëmtuari M.A. i cili detyrohet të kërojë ndihmën mjeksore në Emergjensën e Spitalit Regjional në Gjilan.

- me këtë ka kryer veprë penale rrezikim I trafikut public, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,23,49, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365,451 e 463 të KPP, të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit B.H., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari M.A. nga ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shumën prej 25 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën e përlllogaritur sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit B.H., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës së lartcekur i pandehuri B.H., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, duke shtuar se më vjen keq për rastin e ndodhur, të dëmtuarit i kërkoj falje, ndërsa gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të jetë shumë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit B.H., konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e

prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga e pandehura dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri B.H. nga Gjilani, nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit B.H., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se e pandehuri e ka pranuar fajësinë, se është mësimdhënës sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit fillestar, se i pandehuri ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe faktin se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më e kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese pos demit – lendimit trupor e material te shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit B.H., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 23.01.2018

**Sekretarja juridike,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.